




Pranuar / Dorezuar Prilapen / Prilapen Received / Delivery	06-05-2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Agency Org / Dept	In Proct In Proct Proct No	Shipte / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	2269/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.174/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Ardita Perçuku Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.174/2021 të datës 23.03.2021 të parashtruar nga ankuesi [] i cili përfaqësohet nga Av. [] me adresë Rruga Marie Shllaku, p.n në Komunën e Gjilanit, kundër organit të punësimit, Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.174/2021 e datës 23.03.2021, e parashtruar nga ankuesi []

A r s y e t i m

Ankuesi, [] sipas Akt emërimit të datës 25.07.2011, ka qenë i punësuar në pozitën “Nëpunës i Asistencës Sociale”, në Drejtorin për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, në Komunën e Gjilanit.

Me Vendimin me numër Nr.145 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit të datës 29.02.2016, ankuesit [] ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 01.03.2016, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me këtë vendim ankuesit i është njohur edhe e drejta e pagesës së një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankuesit i është kompensuar dhe se kjo vërtetohet sipas vendimit me numër Nr.220, të datës 31.03.2016.

Ankuesi, [] duk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, ashtu siç i është dhënë këshilla juridike në vendimin Nr.145, të datës 29.02.2016. Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij Av. [] me datë []

09.11.2018 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij Av. _____ me datë 28.12.2020 ka parashtruar kërkesën Nr.05-610-119297 për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit dhe pagave jubilarë.

Kryetari i Komunës së Gjilanit me datë 23.02.2021 i kthen ankuesit përgjigje kërkesën Nr.05-610-119297 të 28.12.2020, duke e njoftuar se ankuesi i ka humbur afatet ligjore dhe se nuk ka vepruar në përputhje me këshillën juridike të vendimit për përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit.

Pas marrjes së përgjigjes së datës 23.02.2021, nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, ankuesi me datë 23.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1318/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Gjilanit. Më datë 10.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjilanit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1318/2021 të datës 23.03.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në krekës e datës 23.02.2021; Kërkesa e datës 28.12.2020; Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 29.02.2016; Vendimi i datës 08.07.2015; Autorizimi i ankuesit dhënë Av.

Aktvendimi A.C.nr.5293/2019, i datës 24.11.2020; i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimi C.nr.974/18, i datës 08.08.2019, i Gjykatës Themelore në Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil; Padia e datës 09.11.2018, e parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil; Kërkesa për përgjigje e datës 26.03.2021; Përgjigja në kërkesë e Komunës së Gjilanit; Akt emërimi i ankuesit i datës 25.07.2011.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar gjitha provat e lëndës të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se në bazë të Vendimit me numër Nr.145 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit të datës 29.02.2016, ankuesit _____ i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 01.03.2016, për shkak të arritjes së moshës së pensionimi. Po ashtu Kolegji ka konstatuar Vendimi me numër Nr.145 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit të datës 29.02.2016, përmban edhe këshillën juridike ku theksohet se: „Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë komisionit të ankesave, brenda autoritetit komunal në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankuesi që nga data 01.03.2016, e që është data e



pensionimit të ankuesit deri me datë 09.11.2018 kur ka parashtruar Padi në Gjykatën Themelore në Gjilan për realizimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor, respektivisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në kuadër të institucionit të punësimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: „Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Vendimit me numër Nr.145 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit të datës 29.02.2016, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 01.03.2016, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa me datë 28.02.2020 ankuesi ka parashtruar ankesën me numër protokolli 1318/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankueses është e palejuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të lëndës, dhe bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.174/2021

Ardita Perçuku Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.